



**Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës**



Nr. 02-052/01-1419, dt. 06.01. 2023

Raportit për funksionimin e Kuvendit Komunal Drenas

Pyetësor për periudhën Janar – Dhjetor 2022

1. Sa mbledhje ka mbajtur Kuvendit të Komunës për periudhën Janar-Dhjetor 2022?

Emri i Komunës	Mbledhje rregullta	Mbl. Jashtëzakonshme	Mbl. urgjente	Mb. solemne
Komuna Drenas	11	2	0	4

2. Gjatë zhvillimit të mbledhjeve a ka pasur raste të lëshimit të mbledhjes apo bojkotim të mbledhjeve nëse po ju lutem të ceket data e mbledhjes dhe arsyeja e lëshimit?

Po ka pasur, në mbledhjen e jashtëzakonshme dt. **08.03.2022**, arsyeja ka qenë nga Opozita, sepse kanë bërë kërkesë me një pikë të vetme për rendin e ditës për mbledhje të jashtëzakonshme, ndërsa në rend dite ishin dy pika, po ashtu me kërkesë nga Kryetari i Komunës po të njëjtën datë dhe ditë. Kjo ishte arsyeja e mos votimit për rend dite nga opozita dhe e lëshuan sallën.

Me dt.24.11.2022 është mbajtur mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Drenasit, ku për diskutim ishin 10 pika për rend dite.

Rendi i ditës u miratua me 10 pikat e lartcekura më lartë, prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar, **(Për)** votuan 20 anëtar, 9 vota kundër, abstenim nuk pati, ndërsa në këtë mbledhje u miratuan vetëm tri pikat e para të rendit të ditës, dhe pas kësaj 16 anëtar të asamblesë komunale lëshuan seancën, 13 anëtar mbeten në sallë ndërsa 2 anëtar munguan, dhe në mungesë kuorumi mbledhja u ndërpre dhe shkoj në pauzë deri në një njoftim të radhës.

Kryesuesi Milaim Hajdari bëri një njoftim me shkrim me protokoll dhe u publikua në ueb faqen zyrtare të Komunës së Drenasit për vazhdimin e Mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit, të mbajtur më 24.11.2022, e cila u ndërpre për mungesë kuorumi, do të mbahet në ditët në vazhdim.

Për datën dhe orën e vazhdimin të Mbledhjes së rregullt, me pikat e Rendit të ditës, do t'ju njoftojmë me kohë.

Pas kësaj u bë njoftimi nga kryesuesi se mbledhja do të vazhdoj me datë: 21.12.2022. Vazhdimi i mbledhjes se ndërprerë të datës 24/11/2022, nuk filloj për shkak të mungesës se kuoromit as me dt. 21.12.2022.

Por edhe pas kësaj u bë njoftimi nga kryesuesi se mbledhja do të vazhdoj me datë 28.12.2022 në ora 14:00.

Vazhdimi i mbledhjes se ndërprerë të datës 24/11/2022, nuk filloj për shkak të mungesës se kuoromit as me datë 28.12.2022.

Pas kësaj prapë kryesuesi beri njoftimin se mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal e ndërprerë në mungesë kuorumi më datë 24/11/2022, e cila po ashtu nuk u vazhdua me datë 21/12/2022 dhe as me datë 28/12/2022 në mungesë kuoromit, vazhdon me datë 30/12/2022 në ora 10:00. Por mbledhja nuk filloj për shkak të mungesës se kuoromit as me datë 30.12.2022.

3. Sa mbledhje ka mbajtur Komiteti për Politike dhe Financa?

- Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur gjithsej **11 mbledhje**.

4. Sa mbledhje ka mbajtur Komiteti për Komunitete?

- **Komuniteti për Komunitete** periudhës Janar-Dhjetor 2022 janë mbajtur 6 mbledhje .
- **Komiteti Konsultativ për persona me Aftesi të Kufizuar** gjatë periudhes Janar-Dhjetor 2022 janë mbajtur 6 mbledhje .
- **Komuniteti Konsultativ për Barazi Gjinore** gjatë periudhes Janar-Dhjetor 2022 janë mbajtur 6 mbledhje.
- **Komuniteti Konsultativ për Kultur Risi dhe Sport** gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022 janë mbajtur 6 mbledhje.

- **Komiteti Konsultativ Për Zhvillim Ekonomik, Mbrojtje të Ambientit, Shëndetsi dhe Mireqenie Sociale** gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022 janë mbajtur 5 mbledhje.
- 5. A ka themeluar kuvendi komunës gjatë këtij viti **komitetet tjerave** nëse po cilat janë ato dhe a kanë mbajtur ndonjë takim të shënohet nr i takimeve për secilin komitet ?
 - **Jo nuk ka themeluar se komitetet janë të themeluara.**
- 6. A ka themeluar **komitet Konsultative** kuvendi komunës gjatë vitit 2022 nëse po shëno cilat dhe numrin e takimeve që kanë mbajtur?
 - **Jo nuk ka themeluar se komitetet janë të themeluara dhe ende nuk i ka përfunduar mandati.**
- 7. **Sa vendime ka miratuar kuvendi i komunës për periudhën Janar – Dhjetor 2022 (te bashkëngjitet lista e vendimeve janar-dhjetor 2022)?**
 - Të bashkëngjitur gjeni raportin e vendimeve në email në PDF, Raporti me nr.02-052/01-67071.
- 8. **Sa rregullore ka miratuar kuvendi i komunës për periudhën Janar – Dhjetor 2022 (Te bashkëngjitet lista me emrat e rregulloreve) ?**

Të bashkëngjitur gjeni raportin e vendimeve në email në PDF.

 - 1.Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin për ndarjen e subvencioneve, protokoli Nr 02-400/01-18380 dt.27.04.2022.
 2. Rregullore për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, vendbanimet dhe Lagjet urbane në Komunën e Drenasit,protokoli nr. 02-030/01-38622, dt. 27.07.2022
- 9. **Sa nga aktet e miratuara nga kuvendi komunës pas vlerësimit të ligjshmërisë nga organi mbikëqyrës ju kanë kthyer në rishqyrtim të shkruhen me emër akti, data e kthimit nga Ministria si dhe data e rishqyrtimit dhe harmonizimit nga komuna si ne tabelën më poshtë:**

Të bashkëngjitur gjeni raportin e vendimeve në email në PDF.
- 10. **A ka raportuar Kryetari i komunës gjatë kësaj periudhe ne kuvendin e komunës nëse po datat e mbledhjes kur ka raportuar dhe për çfarë arsye ka raportuar?**

Kryetari i Komunës ka raportuar dy herë gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2022 përkatësisht” Raporti i Punës Janar-Dhjetor 2021 i Kryetarit dhe Qeverisjes Lokale në mbledhjen e rregullt të Kuvendit Komunal Drenas me dt. **24.03.2022** dhe Raporti i punës Janar-Qershor 2022 i Kryetarit dhe Qeverisjes Lokale u raportua në mbledhjen e rregullt të Kuvendit Komunal Drenas **31.08.2022**

11. Ligji për vetëqeverisje lokale përkatësisht Neni 68 i tij përcakton se komuna mbanë dy takime publike njeri në 6 mujorin e parë a ka mbajtur komuna juaj dy takimet publike nëse po të ceken datat e takimeve publike?

Po, Komuna e Drenasit, përkatësisht kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci ka mbajtur dy takime publike, njërin në gjashtëmujorin e parë të viti dhe tjetrin në fund të vitit. Përkatësisht takimi i parë është thirrur me datën 10.06.2022 ku ftesa mbanë numrin e protokollit 01-212/01-26771 për mbajtjen e takimit me datën 27.06.2022. Takimi i dytë është thirrur me datën 09.12.2022 ku ftesa për takim mbanë numrin e protokollit 01-060-63416 për mbajtjen e takimit me datën 23.12.2022.

Për secilin takim, është respektuar Ligjit për vetëqeverisje lokale, ku ftesa është bërë 14 ditë para mbajtjes së takimit dhe për të dy takimet është mbajtur procesverbal dhe janë publikuar në ueb faqe.

Në ueb faqe, janë publikuar ftesat dhe procesverbalet e gjitha takimeve

12. Të shënohet numri i takimeve publike për rregullore, plane, strategji apo buxhetin komunal?

Gjatë vitit 2022, janë mbajtur 20 takime publike, ku janë përfshirë, konsultime publike, dëgjime buxhetore dhe takime tjera për rregullore e projekte të tjera.

Në muajin Qershor, Komuna ka mbajtur 8 dëgjime buxhetore për Kornizën Afatmesme Buxhetore, një dëgjim të përgjithshëm buxhetor gjinor, një dëgjim me OJQ dhe bizneset si dhe 6 dëgjime të tjera në bashkësi lokale, në Dobroshec, Tërstenik, Baicë, Arllat, Komoran dhe Drenas.

Në muajin Qershor, po ashtu është mbajtur edhe takimi me publikun. Ndërsa në muajin Qershor po ashtu është mbajtur konsultimi publik për rregullorën për zgjedhjen e kryetarve të fshatrave.

Në muajin Gusht është mbajtur një konsultim me publikun shpronësimin e pronave.

Në muajin Shtator janë mbajtur 7 dëgjime buxhetore të organizuar nga Komiteti për Politikë e Financa dhe nga Kuvendi i Komunës për listën e investimeve kapitale, ku janë mbajtur gjithsej 7 dëgjime për listën e investimeve kapitale 2023-2025. Një dëgjim është mbajtur me gratë dhe bizneset dhe 6 dëgjime të tjera në bashkësi lokale, në Dobroshec, Tërstenik, Baicë, Arllat, Komoran dhe Drenas.

Në muajin Dhjetor është mbajtur konsultimi publik për Planin e Integritetit 2023-2026 Dhe me datën 23.12.2022 është mbajtur takimi i fundivitetit.

Të gjitha janë publikuar në ueb faqen zyrtare të komunës

13. A ka te publikuar komuna listën e përgjithshme të pronave të paluajtshme të komunës, si dhe listën e veçantë të pronave që planifikohen për dhënien në shfrytëzim për vitin vijues 2023 ashtu siç përcakton ligji dhe rregullorja për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim e cila thotë që duhet të publikohen deri më deri me 31 dhjetor, duke arsyetuar interesin publik dhe zhvillimin ekonomik të komunës (nëse po vendimin e kuvendit si dhe Linkun e publikimit të listës në Ueb faqe të komunës)?

Po, tek linku i shpalljeve në ueb faqe të komunës është publikuar lista e përgjithshme e pronave të paluajtshme të komunës, e po ashtu është bërë edhe publikimi i listës së veçantë të pronave që planifikohen për dhënie në shfrytëzim për vitin vijues 2023.

14. Sa mbledhje ka mbajtur KKSB për periudhën Janar – Dhjetor 2022?

Në periudhën Janar-Qershor janë mbajtur 3 takime të rregullta, përkatësisht me datë 13 Janar, 15 Mars dhe me datë 13 Maj 2022, ndërsa në periudhën Qershor-Dhjetor janë mbajtur 3 takime të rregullta, përkatësisht me datë 19 Korrik, 21 Tetor dhe 19 Dhjetor 2022.

Gjatë periudhës janar-Dhjetor të vitit 2022 janë mbajtur gjithsej 6 mbledhje të KKSB-së.

Gjithashtu KKSB-ja ka raportuar dy here gjatë vitit 2022, në mbledhjen e rregullt të dt. **27/07/2022** për gjashtë mujorin e parë, Informimi i Kuvendit Komunal për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi dhe në mbledhjen e jashtëzakonshje me dt. **21/12/2022**, Informimi i Kuvendit për aktivitetet e KKSB-së për gjashtë mujorin e dytë.

15. Ju lutem ti cekni temat që janë diskutuar në mbledhjet e KKSB?

Në periudhën Janar-Qershor janë mbajtur 3 takime të rregullta, përkatësisht me datë 13 Janar, 15 Mars dhe me datë 13 Maj 2022. Në këto takime janë diskutuar çështje të cilat lidhen me sigurinë në bashkësi në Komunën e Drenasit, si Siguria e Ambientit, Siguria Shëndetësore, Siguria Rrugore, Siguria Institucionale dhe propozime të tjera.

Në mbledhje janë ftuar anëtarët e KKSB-së dhe monitorues, ku sipas afateve ligjore, përkatësisht 7 ditë para mbajtjes së takimit është dërguar ftesa bashkë me pikat e rendit të ditës, si dhe është publikuar në ueb faqën e komunës së Drenasit.

Në mbledhjen e parë të mbajtur me 13 Janar janë diskutuar këto pika:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSB-së të mbajtur me 22.12.2021;
2. Draft orari i punës së KKSB-së për vitin 2021;
3. Njoftim lidhur me menaxhimin e vërshimeve të fundit;
4. Përgatitjet nga Komisioni Komunal i Zgjedhjeve-KKZ në Drenas për zgjedhjet parlamentare;
5. Informim lidhur me fillimin e gjysmëvjetorin e dytë të vitit shkollor 2021/2021;
6. Trajtimi i qenve endacak;
7. Funksionalizimi i kamerave në Komoran dhe vendosja e kamerave në Komoran 3

Lidhur me këto tema, anëtarët e KKSB-së kanë paraqitur kërkesat e tyre, ku për secilën pikë janë përgjigjur zyrtarët përkatës sipas natyrës së kërkesave.

Mbledhja e dytë është mbajtur me datë 14 prill ku janë diskutuar temat si në vijim:

1. Njoftim për situatën epidemiologjike në Komunën e Drenasit dhe vaksinimi i stafit shëndetësor;
2. Informim lidhur me masat e reja kufizuese dhe përgatitjet për mësimin në distancë;
3. Diskutim për qentë endacak

Po ashtu, gjatë kësaj mbledhje është diskutuar edhe për mbajtjen e mësimin online gjatë pandemisë, përkatësisht problemet e kyçjes në mësimin online e tjera çështje.

Ndërsa, mbledhja e tretë është mbajtur me datë 29 qershor, ku janë diskutuar gjashtë (6) pika si:

1. Njoftim për situatën epidemiologjike dhe vaksinimin në masë;
2. Njoftim lidhur me mbarimin e vitit shkollor 2020/2021;
3. Njoftim lidhur me çështjen e ndriçimit publik dhe mirëmbajtjen e tij;
4. Masat e ndërmarra për sigurimin e ujit të pijes gjatë sezonës së verës;
5. Ndërmarrja e masave parandaluese për zjarrvëniet në natyrë

Ndërsa, të te ndryshmet është diskutuar siguria në trafik, përkatësisht angazhimin e stacionit policor në Drenas për sigurinë në trafik. Për këto mbledhje janë mbajtur procesverbalet nga koordinatori i KKSB-së, janë protokolluar dhe publikuar në ueb faqen zyrtare të Komunës së Drenasit. I njëjti është përcjellur edhe për në Ministrinë e Pushtetit Lokal (MAPL).

Përveç KKSB-së janë mbajtur Këshillat Lokal për Sigurinë Publike ashtu siç parashihet me udhëzim administrativ, gjithsej 5 takime të kryesuar nga kryesuesi i KLSP-së. Në këto takime janë diskutuar tema që lidhen me sigurinë, të cilat mëpastaj janë adresuar në mbledhje të KKSB-së.

Në periudhën **Qershor-Dhjetor** janë mbajtur 3 takime të rregullta, përkatësisht me datë 19 Korrik, 21 Tetor dhe 19 Dhjetor 2022. Mbledhje urgjente apo të jashtëzakonshme nuk ka pasur gjatë këtij gjashtëmujori. Në këto takime janë diskutuar çështje të cilat lidhen me sigurinë në bashkësi në Komunën e Drenasit, si siguria e ambientit, siguria shëndetësore, siguria rugore dhe propozime të tjera të trajtuara nga anëtarët e KKSB-së. Ndërsa, janë mbajtur poashtu tri mbledhje të Këshillit Lokal për Siguri Publike, ku janë trajtuar tema që ndërlidhen me sigurinë publike në komunën e Drenasit.

Në mbledhje janë ftuar anëtarët e KKSB-së dhe monitorues, ku sipas afateve ligjore, përkatësisht 7 ditë para mbajtjes së takimit është dërguar ftesa bashkë me pikat e rendit të ditës,

si dhe është publikuar me kohë në ueb faqen e komunës së Drenasit. Pra, lidhur me afatet ligjore, gjithmonë janë respektuar në thirrjet e KKSB-së.

Në mbledhjen e mbajtur me 19 korrik kanë marr pjesë 17 anëtarë dhe janë diskutuar këto pika:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSB-së; <https://kk.rks-gov.net/gllogoc/ep-content/uploads/sites/10/2022/05/Procesverbali-i-mbledhjes-se-KKSB-se-se-trete-2022.pdf>
2. Përfundimi i vitit shkollor 2021/2022;
3. Sinjalizimi horizontal dhe vertikal në rrugët e komunës së Drenasit;
4. Të ndryshme.

Lidhur me këto pika, anëtarët e KKSB-së janë informuar nga personat kompetent, dhe janë përgjigjur në pyetjet e adresuara varësisht nga natyra e tyre. Për sinjalizimin horizontal dhe vertical, DSHPE njoftoi se në këtë pikë Drenasi qëndron mirë dhe ka projekte që është në implementim e sipër. Gjithashtu, u ngritën disa pyetje lidhur me sigurinë në përgjithësi. Për këtë mbledhje është hartuar procesverbal brenda afatit ligjor, i është dërguar anëtarëve si dhe përfaqësuesve në MAPL. Po ashtu, është publikuar në ueb faqe, linku: <https://kk.rks-gov.net/gllogoc/ep-content/uploads/sites/10/2022/10/Procesverbali-i-KKSB-se-se-dates-19.07.2022.pdf>

Mbledhja e dytë është mbajtur me datë 21 tetor në sallën e Kuvendit Komunal dhe kanë marr pjesë 17 anëtar. Në këtë mbledhje janë diskutuar temat si në vijim:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSB-së të mbajtur me datë 19.07.2022: <https://kk.rks-gov.net/.../keshilli-komunal-per-siguri.../>
2. Përgatitjet dhe fillimi i vitit të ri shkollor 2022/2023;
3. Muaji i Ndërgjegjësimit për Sëmundjet Kanceroze të Gjirit;
4. Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 28/ 96 të datës 14.09.2022 në lidhje me zbatimin e masave detyruese për kursim të energjisë elektrike
5. Të ndryshme.

Në pikën e dytë anëtarët e KKSB-së diskutuan edhe për çështjen e zëvendësimit të orëve, ku nga DKA u njoftuan se prindërit nuk janë pajtuar që zëvendësimi të bëhet në ditë pushimi për nxënësit. Gjithashtu, u ngrit çështja e qenve endacak që në sezonin e dimrit paraqet një dukuri shqetësuese sidomos për fëmijët, DSHPE njoftoi se është marrëveshja me StrayCoco për

trajtimin e qeneve dhe se çdo rast duhet të raportohet të menjëherë I kësaj marrëveshje. Kurse, në pikën e katërt, anëtarët u njoftuan se komuna ka pranuar Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 28/ 96 të datës 14.09.2022 në lidhje me zbatimin e masave detyruese për kursim të energjisë elektrike, dhe se po veprojnë konform këtij vendimi. Për këtë mbledhje është hartuar procesverbal nga koordinatori i KKS-së, dhe është përcjell me kohë tek anëtarët, si dhe është publikuar në ueb faqen e komunës në linkun: <https://kk.rks-gov.net/gllogoc/ep-content/uploads/sites/10/2022/11/Procesverbali-i-KKS-se-se-dates-21.10.2022.pdf>.

Mbledhja e fundit për vitin 2022 u mbajt me datë 19 Dhjetor, ku morën pjesë anëtarë. Në këtë mbledhje u diskutuan këto pika:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKS-së të mbajtur me datë 21.10.2022: <https://kk.rks-gov.net/gllogoc/ep-content/uploads/sites/10/2022/11/Procesverbali-i-KKS-se-se-dates-21.10.2022.pdf>
2. Raport lidhur me vërshimet gjatë muajit Nëntor në Komunën e Drenasit;
3. Raport lidhur rastet e dhunës në familje- Tryeza për parandalimin e dhunës në kuadër të fushatës '16 aktivizim kundër dhunës me bazë gjinore';
4. Të ndryshme

Në këtë mbledhje u paraqit një raport lidhur me vërshimet në komunën e Drenasit dhe intervenimet që janë bërë sipas kërkesave të qytetarëve. Si dhe u njoftuan për formimin e komisionit për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore, të cilat pas përfundimit të vlerësimit do të procedohen në nivelin qendror për kompensim. Ndërsa, për rastet e dhunës mbi bazë gjinore nga zyrtarët policor të Drenasit anëtarët u informuan për statistikën e dhunës. Në këtë pikë u theksua vetëdijësimi i qytetarëve në vitet e fundit për raportim të dhunës në organet përkatëse. Në këtë mbledhje të pranishëm si monitorues ishin prezent edhe nga LMT e KFOR-it Slloven si dhe përfaqësues të UNMIK-ut njëherësh.



Shëfë e zyrës së Kuvendit

Zahrie Podrimçaku Subashi